



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.1142/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj-Kryesuese, Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtarë , duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Kllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Komunën e Kllokotit, për shkak të shitblerjes së votave, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 17.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET i bazuar ankesa A.nr.1142/2021 i datës 16.11.2021, e paraqitur nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Kllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Kllokot, ndërsa Subjektit Politik Lista Serbe, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 10,100 euro (dhjetmijë e një qind), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

II. DETYROHET subjekti politik Lista Serbe, që gjobën e shqiptuar si në pikën -1- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënimin e dënimit shtesë.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 15.11.2021, ka pranuar një ankesë nga Strahinja Spasiq, kandidat për Kryetar Komune të Kllokotit, nga radhët e Subjektit politik GI Srpska Narodna Sloga, me seli në Komunën e Kllokotit me të cilën pretendon se edhe pse ka paraqit ankesë për parregullsitë e zgjedhjeve dhe keqpërdorimeve nga subjekti politik Lista Srpska në raundin e parë dhe se ankesa është pranuar vetëm pjesërisht dhe nga PZAP-i, Lista Srpska vetëm është gjobitur, por Lista Srpska dhe zyrtaret e saj kanë vazhduar me keqpërdorime dhe manipulime si në sistemin e Kosovës ashtu edhe në atë siç e quan të Serbisë në periudhën ndërmjet rrethit të dytë të zgjedhjeve si dhe në ditën e zgjedhjeve më 14 nëntor 2021. Në vazhdim të ankesës pretendohet se gjatë periudhës ndërmjet raundit të parë dhe të dytë kreu i administratës shkollore siç e quan në sistemin e Republikës së Serbisë, Ivan Zaporozhac, iu ka bërë thirrje të gjithë punëtorëve të arsimit që të paraqiten në selinë e administratës shkollore në Mitrovicë dhe ju ka bërë presion ndaj të gjithë punëtorëve të arsimit se duhet ta votojnë Listën Srpska në zgjedhje në të kundërtën do të largohen nga puna. Ky presion është bërë edhe nga drejtoret e shkollave në komunën e Kllokotit në sistemin e Serbisë dhe Kosovës Bojana Marinković, Trajan Trajković, Dalibor Dajiq dhe Vladan Bogdanović i cili ka qen edhe kandidat për kryetar të komunës së Kllokotit, si dhe Goran Marinković drejtor i departamentit për arsim në komunën e Kllokotit. Më tutje në ankesë thekson se presion është bërë edhe nga kryetari i

komunës së Kllokotit, Bozidar Dejanoviq dhe Kryetari i Kuvendit Zharko Dejanoviq ndaj zyrtarëve të komunës së Kllokotit me kërcënimin se nëse nuk votojnë Listën Srpska do të largohen nga puna. Bozidar Dejanoviq në cilësinë e kryetarit të komunës së Kllokotit theksohet se ka dhënë më shumë se 50 kontrata mbi vepër vetëm për të votuar Listën Srpska, po ashtu shumë kontrata mbi vepër janë dhënë edhe nga drejtori i shkollës në sistemin serb në këmbim që ata të votojnë Listën Srpska. Paraqitsi i ankesës pretendon se presion është bërë edhe nga drejtori i spitalit në Pasjan, Zoran Periq, ndaj punëtorëve shëndetësorë që të votojnë Listën Srpska, gjithashtu ka urdhëruar mjekët që të japin pushime mjeksore të rrejshme kinse se janë të sëmurë nga virusi Covid-19, punëtorëve të arsimit dhe shëndetësisë me qëllim që në vend që në vende të tyre të punësojnë punëtor të ri me afat një mujor në vend të tyre në mënyrë që ata të votojnë Listën Srpska. Kryetar i Komunës së Gjilanit siç e theksojnë në ankesë të sistemit serb në të njëjtën kohë dhe kryetar i sapozgjedhur i Novo Brodes Sasha Millosheviq-Belli dhe kryetar siç e quajnë i komunës së Vitisë Srgjan Nikoliq në sistemin e Republikës së Serbisë në javën e fundit para rrethit të dytë të zgjedhjeve për Komunën e Kllokotit kanë thirrur në zyrat e tyre votuesit e komunës së Kllokotit dhe u kanë ndarë zarf me para në shumë prej 10.000,00 dinarë për të votuar Listën Srpska.

Më tutje paraqitësi i ankesës theksoi se edhe Srgjan Nikoliq, siç e quajnë kryetar i komunës së Vitisë në sistemin serb, së bashku me Sasha Mirkoviq, Zoran Cvetkoviq, Zvezdan Simiq dhe Vlast Bogdanoviq, ndërmjet dy raundeve të zgjedhjeve kanë ndarë kontrata për ndarjen e materialit ndërtimor në këmbim për të votuar për Listën Srpska. Në vazhdim të ankesës theksohet se krahas aktakuzave të ngritura kundër katër personave për blerje votash nga Prokuroria e Gjilanit në raundin e parë të zgjedhjeve për blerjen e votave, anëtarët e Listës Srpska, kanë vazhduar të njejtat veprime edhe në raundin e dytë për zgjedhjen e kryetarit. Parashtruesi i ankesës pretendon se sipas informatave mjetet për blerjen e votave i ka siguruar Sasha Milosheviq-Belli ndërsa i kanë ndarë Bozidar dhe Zarko Dejanoviq, Goran Marinkovic, Sasha Mirkovic, Sasha Marinkoviq, Vladan Bogdanoviq, Zoran Cvetkoviq, Radomir Stankoviq, Dalibor Stojanoviq dhe disa persona të tjerë që theksojnë se duhet të vërtetohet nga një hetim i policisë dhe prokurorisë. Parshtruesi i ankesës shton se në ditën e zgjedhjeve të Raundit të Dytë të Zgjedhjeve, gjithashtu është bërë presion dhe blerje të votave dhe se një numër i madh i votuesve janë detyruar të votojnë me asistencë edhe pse ishin të aftë që vet të votojnë, në fletvotime të vendosin simbole të caktuara dhe duhej të tregonin fletëvotimin anëtarit të komisionit të zgjedhorë të Listës Srpska se për kë kanë votuar dhe shumë keqpërdorime të tjera. Parashtruesi ankesës thekson se të gjithë këta persona përfaqsojnë siç thekson institucionet e Republikës së Serbisë të cilat funksionojnë në Kosovë dhe është shkelur rënë e drejta e qytejarëve në Komunën Kllokotit si dhe konstaton se zgjedhjet nuk u zhvilluan në një atmosferë të drejtë dhe demokratike, siç thekson se ka pasur shumë keqpërdorime, përvetësime dhe blerje votash.

Ankesë si dëshmi i ka bashkangjitur Dëshminë -Publikimi i Info-Plus mbi Presionin e Votuesve të datës 15.11.2021, deklaratat e votuesve në PZAP, si dhe deklaratat e votuesve të bashkangjitur ankesës si dëshmi shtesë

PZAP lidhur me ankesë Anr.1142/2021, më datë 16.11.2021, i ka dërguar kërkesë për përgjigje subjektit politik Lista Serbe, duke i dhënë afat për përgjigje, deri më datë 17.11.2021 në ora 9:00 dhe po të njëjtën datë ka pranuar përgjigjen nga Subjekti Politik Lista Serbe.

Në përgjigjen e Subjektit Politik Lista Serbe në të cilën pretendon se parashtruesi i ankesës shkroi një pamflet politik pasi që të njëjtë i humbën zgjedhjet e rregullta dhe sipas përgjigjes

ankuesi në ankesë askund nuk i specifikon ngjarjet që ai i pretendon si shkelje të ligjit por vetëm në përgjithsi ka paraqitur si një mori shkeljesh të Ligjit Zgjedhor pa specifikuar se me cilin ligj, pa përshkruar ku dhe kur ka ndodhur veprat penale, evidentimi i saktë i shkeljes ku është obligim i paraqitsit të apelit në PZAP. Mëtejë në përgjigje Lista Serbe shton se Subjekti Politik GI Srpska Narodna Sloga pretendimet në ankesën Anr.1142 ka paraqitur si dëshmi materialet të cilat i dëshmojnë veprimet që kanë ndodhur shumë para ditës së zgjedhjeve dhe pas mbajtjes së zgjedhjeve të cilat sipas subjektit politik Lista Serbe janë në kundërshtim me Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe se obligim i ofrimit të dëshmive për shkeljen e pretenduar është i parashtuesit të ankesës. Në vazhdim të përgjigjës Lista Serbe thekson se dëshmitë të cilat janë dorëzuar nga ankuesit lidhur me mesazhet nuk kanë datë se kur ka ndodhur shkelja, ndërsa sa i përket deklaratave të Srdjan Jetrenić kanë ndodhur me 15.10.2021 dhe deklarata e dëshmitarit Arbër Emini ka ndodhur me 06.11.2021, si dhe deklaratat e dëshmitarëve të bashkangjitura në ankesë ka ndodhur me datën 15.10.2021 dhe 06.11.2021 gjë që janë të pasafatshme dhe nuk kanë asnjë përshkrim apo fakt lidhur me ndonjë shkelje të ligjit. Kërkon që ankesa e GI Srpska Narodna Sloga të hudhet si e pabazuar.

Në përgjigje në ankesë KQZ-ja, ka theksuar se, në Dhomën Operative të KQZ-së, është paraqitur një ankues (z/Sergjan Jerenic) qytetar i Republikës së Kosovës, përmes numrit të telefonit +383 49 798 – 299, i cili fillimisht ka telefonuar në numrin mobil zyrtar (+383 45 888 101) të paraqitur në Planin Operacional për Ditën e Zgjedhjeve të datës 14.11.2021 rreth orës 20:00, mirëpo i njëjti ishte i pa qarte gjatë bisedës, ku paraqitja e tij në telefon ishte sikurse e “frustruar”, ndërsa ata nga Dhoma Operative kanë kërkuar që ankesën e tij ta parqes edhe përmes mesazhit të telefonit, me qëllim që ata, Policia dhe Prokuroria të marrin masa të menjëhershme, mirëpo mesazhi i ankuesit ka arritur në numrin zyrtar mobil të Dhomës Operative në ora 20:57 minuta me tekstin si ne vijim:

“Sergjan Jerenic Qytetarë i Republikës së Kosovës, është detyruar nga Dalibor Dajici cili është Profesor në Shkollën Teknike Në Verboc dhe drejtor i Shkollës në sistemin paralel e ka detyruar Sergjanin të Votoj për Listën Serbe në të kundërtën do të marrë ndëshkime nga Serbia ai dhe familja e tij. Ka theksuar se edhe Zoran Spasic është detyru nga Ivan Zaprogjac me votu për Listën Serbe në Vend Votimin në Sveti Sava. Nebojsa Stevic është Detyruar nga Ivan Zaprogjac të Votojë për Listën Serbe në shkollën fillore Sveti Sava Kllokot Svetlana Stojkovic është detyruar me votu për Listën Serbe nga Zoran Peric. Këta dhe shumë të tjerë Sergjan thekson se do bëjnë ankesë në PZAP se si Qytetarët të Republikës së Kosovës ju është cenuar e drejta e Votimit të Lirë. Sipas Sergjanit ka fletvotime të ndryshme me simbole të Ndryshme që kanë ardh si pasoj e blerjes së votave dhe presionit nga Lista Serbe. Nga Sergjan Jerenic.”

Në vazhdim të përgjigjës theksohet se nga Dhoma Operative, gjatë bisedës telefonike kanë kërkuar nga ankuesi që të ofrojë ndonjë dëshmi lidhur me pretendimet e tij, mirëpo i njëjti vetëm mesazhin telefonik të lartë shënuar ka ofruar si dëshmi, gjë që pas mbylljes së QV-ve dhe numrimit të votave, kur në këtë kohë nëpër QV nuk kishte staf zgjedhor, ishte e vështirë të ndërmarim veprimet e menjëhershme nga Dhoma Operative, dhe se për këtë, kanë rekomanduar që të paraqitet tek Policia në komunën e Kllokotit, pasi që informata e lartshënuar për Dhomën Operative ishte paksa sfiduese në vërtetimin e asaj çka është thënë në mesazh, në kohën dhe mesazhin pa ofruar ndonjë dëshmi.

Në fund të përgjigjes KQZ theksoi se nga të lartshënuarit nuk kanë pranuar asnjë ankesë, telefonatë, apo informatë për ndonjë parregullsi në këtë komunë përgjatë procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve me datë 14.11.2021 në Komunën e Kllokotit. Përgjigjes në ankesë ia ka bashkangjitur Librin e Votimit sipas kërkesës së PZAP-it për vendvotimet: 3701D/01R, 3702D/01D, 3703D/02D, 3705D/01D, 3701D/02D dhe 3703D/01R, 3704D/01D në Kllokot.

Paneli për të vërtetuar gjendjen faktike, vlerësoi provat si në vijim: Raportin e Policisë të datës 16.11.2021, Njoftimin e Prokurorisë së Shtetit dhe përgjigjen në apel të KQZ-së, e dhënë në formë raporti nga Dhoma Operative e KQZ-së.

Paneli, pasi që vlerësoi secilën nga provat një nga një, dhe të gjitha së bashku, gjeti se:

Apeli është i bazuar, për këto arsye:

Me Raportin e Policisë të datës 16.11.2021, Paneli vërtetoi se pretendimet që lidhen me procesin zgjedhor e që janë në lidhshmëri me rastin që është objekt i shqyrtimit, janë ndërmarr veprime të verifikimit, në drejtim të veprës penale “Cenim i përcaktimit të lirë të votuesve”, vepër penale e sanksionuar me nenin 210 të KPRK-së. Në raport është theksuar se në Komunën e Kllokotit, gjatë ditës së Zgjedhjeve kanë marrë disa informacione për dyshime të shitblerjes së votave për të cilat ka qenë në dijeni edhe prokurori i shtetit, mirëpo nuk kanë arrit të konfirmojmë vërtetësinë e këtyre informatave. Gjithashtu në raport është theksuar se është pranuar një informacion se drejtori i shkollës teknike në fshatin Vërboc, Dalibor Dajic, ka kërcënuar me largim nga puna Srdjan Jeremic, i cili punon si profesor në këtë shkollë, ku në bazë të informatave i njejt i ishte kërcënuar se nëse nuk e voton Listën Serbe, do ta largonin nga puna ashtu sic e kanë larguar bashkëshorten e ti për shkak të zgjedhjeve. Ndërsa pos këtyre ankesave, sipas raportit të policisë rezultoi se nuk kishte ankesa të tjera deri në përfundim të procesit zgjedhor. Po ashtu nga raporti i Prokurorisë së shtetit si përgjigje në verifikimet e PZAP-ës, rezultoi se nuk ka filluar ndonjë procedure penale për rastin konkret që parashtruesi i apelit ka parashtruar.

Nga përgjigja në ankesë e KQZ-së, e dhënë në formë të raportit nga Dhoma Operative e KQZ-së, që është funksionale në ditën e votimit, në të cilën Dhomë Operative, paraqiten të gjitha parregullsitë eventuale gjatë procesit të votimit, paneli konstatoi se në këtë Dhomë Operative, është pranuar një telefonatë për Ditën e Zgjedhjeve të datës 14.11.2021 rreth orës 20:00, dhe sipas përgjigjes së KQZ-së, rezultoi fakti se ankuesi ka paraqitur ankesë përmesë sms, pasi një gjë të tillë i është kërkuar nga personat përgjegjës të Dhomës Operative. I njejt në sms ka paraqitur parregullsinë që ka ndodhur në ditën e zgjedhjeve dhe kërcënimet që ka marrur, sic është theksuar në përgjigje të KQZ-së.

Paneli pas vlerësimit të secilës provë si më lart dhe të gjitha provave në tërësinë e tyre, vjen në përfundim se subjekti politik Lista Serbe, me veprimet e mbështetësve të saj e ka thyer Kodin e Mirësjelljes, duke kërcënuar personat votues që nëse nuk votojnë listën Serbe do të shkarkohen nga postet e tyre, nëpër institucionet që punojnë sipas strukturave paralele të paktën këto provohen në baze të provave në raport me, deklaratat e dëshmitarëve, Mica Spasic, Krcmarevic Ognjem, Kojic Danijel, Kojic Srečko dhe Rade Gjuric, si dhe nga incizimi audio ku rezultoi se Srdjan Jerenic ishte ftuar në shkollë ku mbështetësi i Listës Serbe i kishte bërë presion në përcaktimin e lire të votimit dhe që i kërkonin që ai dhe bashkëshortja të vononin Listën Serbe, ku që të gjithë kanë pohuar në deklaratimet e

parashtruara se janë ftuar nga mbështetës të Listës Serbe që të votohet ky subjekt politik dhe duke iu premtuar të holla, përkatësisht duke iu bere presion ne raport me punën e familjareve të tyre, e që bie në kundërshtim me nenin 33 pika f) i LZP-së. Andaj paneli vendosi si në pikat -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohen me nenin 117 par. 3 të LZP-së, ku parashihet se: *“Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i, mbështetët në dëshmi të qarta dhe bindëse”* siç edhe ishin në rastin konkret provat e theksuara me sipër që argumentojnë se ne të vërtetë mbështetësit e subjektit politik kishin ndërmarr veprime për të ndikuar në përcaktimin e lire të votuesve.

Paneli, pasi që erdhi në përfundim dhe përcaktoi, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 të LZP-së, se ka ndodhur shkelje e këtij ligji dhe rregullave të KQZ-së, nga ana e mbështetësve të subjektit politik Lista Serbe, në ditën e votimit të datës 14.11.2021, e që kanë ndikuar sipas ankuesit në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, paneli vlerësoi së në këtë rast është thyer Kodi i Mirësjelljes, për subjektet politike, në kuptim të nenit 33 pika f) i LZP-së. Andaj paneli vendosi një gjobë ndaj subjektit politik Lista Serbe, në lartësi prej 10,100.00 euro, siç është vendosur në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi. Kjo gjobë në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet e tilla që bien ndesh me rregullativën ligjore-zgjedhore, dhe si të tilla cenojnë klimën e qetë dhe të përshtatshme për votim të lirë dhe të pa ndikuar, si bazament i një procesi demokratik zgjedhor, për të cilën shkelje paneli mund të shqiptoi gjobë ndaj një subjekti politik, deri në 50,000.00 euro, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c) i LZP-së. Poashtu paneli me rastin e shqiptimit të gjobës, në këtë rast u mbështet edhe në rrethanat e rastit siç janë natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes, gjithashtu si rrethanë paneli e mori faktin se subjekti politik Lista Serbe, ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, dhe ka marr mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi, nuk e paguan gjobën e shqiptuar, brenda afatit të përcaktuar si në pikën -I-, të dispozitiv të këtij vendimi, atëherë në pajtim me nenin 120 paragrafi 2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: *“Dështimi për të paguar dënimin apo për t’iu bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”*

Përkundër se ne apel parashtruesi nuk kishte kërkesë lidhur me rivotimin në Komunën e Killokotit, Paneli vlerëson se me asnjë nga provat e vlerësuara si më lart nuk është vërtetur se është ushtruar parregullsi në ndonjë vendvotim që do ta cenonte integritetin e rezultatit zgjedhor, gjë që pas verifikimit të Librave të Votimit për vevndotimet e lartcekura nuk është shënuar asnjë parregullsi përveç numrit të votuesve të cilët kanë votuar me asistencë po ashtu as në polici nuk është paraqitur ndonjë ankesë apo kallëzim penal që ka të bëjë me çështjen e rezultatit zgjedhor në ditën e votimit nëpër vendvotime apo të procesit zgjedhor si tersi, e as në qendrën e votimit ditën e zgjedhjeve, prandaj nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat nga se nuk rezulton në asnjë prove që edhe përkundër se rezulton ndikimi i lire të votuesit siç u argumentua me sipër që të ketë cenuar edhe rezultatit zgjedhor, e kjo bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe

bindëse se kishte parregullsi të asaj natyre në ditën e votimit që do të argumentohej dërgimi i Komunës së Kollokotit në rivotim të tërësishëm. Për tu anuluar rezultati për një subjekt politik, vërtetë duhet që gjatë procesit paraprak të votimit të jenë bërë shkelje zgjedhore shumë serioze në ditën e votimit, si rezultat i të cilave procesi i votimit dhe integriteti zgjedhor të jetë minuar seriozisht dhe që zgjedhjet të dalin pa integritet. Lidhur me pretendimet se kryetarët e komunave nga struktura paralele serbe Novo Bërdë, Gjilan dhe Viti se i kanë thirrur përfaqësuesit e zyrave të tyre në Komunë Killokotit me qëllim të që votueset të Listës serbe të ju ndaht ng anjë zarf me shumën prej 10000 dinarë, mirëpo Paneli vlerëson se vërtetë për këtë pretendim të blerjes se votave në shumën prej 10.000 dinarë parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur ndonjë prove përveç faktit se ka theksuar rrethanat e tilla në ankese, andaj Paneli vlerëson se pretendimi i tille duhet të jete i mbështetur në prova konkrete dhe të qarta për të rezultuar si i bazuar.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit të apelit, ku nga verifikimet e PZAP-ës, rezultojnë se në tërë qendrën e Votimit ka pasur asistim të rreth 70 personave, megjithatë nuk rezultojnë nga të dhënat e shënimeve që janë mbajtur nga komisioni zgjedhor, që në asnjë rast të njëjti person të ketë asistuar me shume se një personi, rrjedhimisht asistimi për shkaqe të arsyeshme është i lejuar dhe ai asistim duhet të evidentohet, gjithë që evidentimi në raport me çdo asistim rezultojnë se ishte bërë nga anëtarët e komisionit andaj veprimet e tilla nuk përbëjnë shkelje ligjore përderisa asistimi është zbatuar në përputhje me rregullat zgjedhore.

Paneli rikujton se gjopa e shqiptuar në këtë rast në kuptim të nenit 120 paragrafi 5 të LZP-së, është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksionimi penal që mund të pasojë, pasi që vendimet e PZAP-së, janë vendime administrative, dhe në asnjë rast nuk e paragjykon çështjen për zhvillimin e një procedure tjetër.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 dhe 120 të LZP-së, Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr.1142/2021 më datën 17.11.2021

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.